

UDHËZUES PËR KONSULTIMET PUBLIKE

Udhëzues praktik për qytetarët, organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e interesit mbi pjesëmarrjen dhe ndikimin në procesin e vendimmarrjes qendrore



Institute
for Democracy
and Mediation



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

Udhëzues për Konsultimet Publike për Aktorët Jo-Publikë

Udhëzues praktik për qytetarët, organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e interesit mbi pjesëmarrjen dhe ndikimin në procesin e vendimmarrjes qendrore

Ky udhëzues është hartuar në kuadër të projektit "Forcimi i Transparencës dhe Qeverisjes së Mirë" i cili zbatohet nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) me mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED).

Përmbajtja e këtij publikimi nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e NED. Të drejtat e autorit për këtë publikim i përkasin vetëm IDM-së.

Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet apo të transmetohet në asnjë formë apo mënyrë pa miratimin paraprak me shkrim të IDM-së.



Institute
for Democracy
and Mediation



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

Parathënie

Ky udhëzues është zhvilluar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim për t'iu përgjigjur nevojës në rritje për një kuptim më të thellë dhe praktik të proceseve të konsultimit publik në Shqipëri. Përvoja e deritanishme ka treguar se, megjithëse ekziston një bazë ligjore e qartë për njoftimin dhe përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje, zbatimi i saj shpesh mbetet formal dhe i pabarabartë ndërmjet institucioneve. Kjo ka krijuar boshllëqe që pengojnë pjesëmarrjen e kuptimplotë dhe zvogëlojnë mundësitë për ndërtimin e besimit midis qytetarëve dhe institucioneve publike. Hartimi i këtij udhëzuesi synon të japë një përgjigje konkrete për këto sfida, duke ofruar njohuri dhe mjete praktike për të rritur cilësinë e angazhimit qytetar dhe transparencën institucionale.

Udhëzuesi është menduar për aktorë jo-publikë si organizatat e shoqërisë civile, akademikë, grupe interesi, gazetarë dhe individë të angazhuar të cilët dëshirojnë të marrin një rol më aktiv dhe më të informuar në proceset e konsultimit publik. Ky dokument shërben si një mjet orientues, që shpjegon hapat kryesorë të konsultimit, të drejtat dhe detyrimet e palëve të përfshira, si dhe ofron këshilla praktike për angazhim efektiv. Qasja e tij është e thjeshtë dhe e strukturuar, për ta bërë lehtësisht të përdorshëm si nga profesionistët me eksperiencë ashtu edhe nga qytetarët që po angazhohen për herë të parë në këtë fushë. Shpresojmë që ky dokument të shërbejë si një pikë referimi e qëndrueshme dhe si një nxitje për rritjen e kulturës së dialogut dhe bashkëpunimit mes institucioneve dhe publikut, në mënyrë që konsultimet publike të bëhen një mjet i vërtetë i qeverisjes demokratike dhe jo thjesht një detyrim formal.

Tabela e Përmbajtjes

Fjalorth i termave	3
1. Konsultimi publik si shtyllë e qeverisjes demokratike	4
2. Kuadri ligjor dhe institucional	5
3. Llojet e konsultimeve publike	7
4. Hapat kryesorë institucional në procesin e konsultimit publik	8
5. Çfarë aktesh përfshihen në konsultim?	9
6. Kush mund të marrë pjesë?	10
7. Ndjekja dhe monitorimi i konsultimeve publike	11
8. Si të angazhohesh në mënyrë efektive?	12
9. Pengesat e zakonshme dhe si mund t'i kapërceni ato	14
10. Matja dhe treguesit e suksesit	15
11. Praktika të mira	16
12. Listë kontrolli për pjesëmarrje efektive	18
13. Rugëtimi i pjesëmarrjes efektive në konsultime	19

Fjalorth i termave

Konsultim publik - Proces përmes të cilit institucionet publike angazhojnë palët e interesuara për të mbledhur mendime, komente dhe propozime mbi projektaktet dhe politikat para miratimit të tyre.

Projektakt - Versioni paraprak i një ligji, akti nënligjor ose dokumenti politikash që i nënshtrohet konsultimit publik para se të miratohet.

Raport individual i projektaktit - Dokument përmbledhës që tregon rezultatet e konsultimeve për një projektakt specifik, përfshirë komentet e marra dhe mënyrën se si janë adresuar ato.

Plani individual i projektaktit - Dokument planifikues që përcakton hapat, afatet, palët e interesuara dhe burimet e nevojshme për zhvillimin e konsultimit për një projektakt të caktuar.

Palë të interesuara - përfshin çdo individ, grup apo organizatë që ndikohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga një politikë apo vendim publik, ose që ka njohuri dhe interes për të ndihmuar në përmirësimin e përmbajtjes së një dokumenti.

Grupe interesi – Bashkësi të interesuara si organizata të shoqërisë civile, biznese, grupe të interesit dhe qytetarë që nuk janë pjesë e administratës publike por marrin pjesë në proceset e konsultimit.

Koordinator institucional - Punonjësi i institucionit publik i ngarkuar me menaxhimin e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik dhe me mbajtjen e kontakteve me palët e interesuara.

Raport vjetor i transparencës - Dokument i përgatitur nga Kryeministria që përmbledh të dhënat mbi performancën e ministrive dhe institucioneve në zhvillimin e konsultimeve publike gjatë një viti.

Regjistri Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik (RENJKP) - Platforma online ku publikohen njoftimet, dokumentet dhe rezultatet e konsultimeve publike për të siguruar transparencë dhe akses të barabartë.

Raporti VNR - Raporti i Vlerësimit të Ndikimit Rregullator analizon në avancë efektet e mundshme të një projektakti, duke mbështetur vendimmarrjen e bazuar në evidencë.

Plan Vjetor i Konsultimit Publik (PVKP) - Dokument i hartuar nga ministritë dhe institucionet që përcakton të gjithë projektaktet e planifikuara për konsultim gjatë vitit dhe afatet përkatëse.

Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve (PPAP) - Dokument ku renditen dhe planifikohen projektaktet që priten të hartohen dhe miratohen gjatë një viti nga institucionet publike.

1. Konsultimi publik si shtyllë e qeverisjes demokratike

Çfarë është konsultimi publik?

Konsultimi publik është një proces përmes së cilit institucionet publike angazhojnë individët, organizatat dhe aktorët kyç në hartimin e politikave, strategjive, ligjeve dhe proceseve të tjera vendimmarrëse. Konsultimet synojnë të mbledhin opinione, të dhëna dhe reagime prej atyre që potencialisht do të ndikohen nga projektakti në fjalë, ose që kanë ekspertizë mbi këtë të fundit. Këto procese sigurojnë që vendimmarrja të jetë më transparente, gjithëpërfshirëse dhe e përgjegjshme ndaj nevojave shoqërore. Konsultimet nuk janë thjesht një akt i informimit të publikut por përfaqësojnë një mundësi për dialog dhe influencë qytetare.

Pse ka rëndësi për qeverisjen demokratike?

Konsultimi publik përforcon qeverisjen demokratike duke promovuar pjesëmarrje, transparencë dhe llogaridhënie. Ai siguron që politikat janë më reflektuese ndaj interesit publik dhe ndihmon në ndërtimin e besimit midis qytetarëve dhe institucioneve. Kur qytetarët ndiejnë se zërat e tyre janë duke u marrë në konsideratë, ata janë më të prirur të mbështesin vendimet e marra. Për qeveritë, konsultimi mund të përmirësojë cilësinë e ligjeve dhe politikave përmes identifikimit të hershëm të pengesave, zbulimit të çështjeve të anashkaluara, dhe zhvillimit të legjitimitetit dhe qëndrueshmërisë së reformave. Për shoqërinë tonë, konsultimet mundësojnë një kanal për angazhim civil dhe bashkë-përgjegjësi në qeverisje.

Roli i aktorëve jo-publikë në ekosistemin e konsultimeve

Teksa përgjegjësia ligjore për mbajtjen e konsultimeve i përket institucioneve publike, aktorët jo-publikë si organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të), institucionet akademike, shoqatat profesionale, media dhe ekspertët individualë, luajnë një rol thelbësor në formësimin e një ekosistemi të qëndrueshëm konsultimi. Këta aktorë shërbejnë si vëzhgues, advokues, dhe lehtësues të angazhimit publik përmes rritjes së ndërgjegjes publike, monitorimit të performancës institucionale, mundësimit të ekspertizës kundrejt projektakteve, dhe ofrimit të sigurisë që zërat e grupeve të marginalizuar të gjejnë përfaqësi.

Më tej, aktorët jo-publikë ndihmojnë në përafrimin e hendeqeve ekzistuese midis institucioneve dhe komuniteteve. Përmes pjesëmarrjes aktive dhe konstruktive në proceset e konsultimit, ata kontribuojnë për një politikbërje gjithëpërfshirëse, llogaridhënëse, dhe të bazuar në evidenca. Në këtë kontekst, fuqizimi i aktorëve jo-publikë me mjete praktike dhe njohuri mbi se si funksionojnë konsultimet në teori dhe praktikë, është thelbësor. Ky udhëzues synon të shërbejë pikërisht për këtë qëllim: të ofrojë informacion dhe udhëzime praktike e të lehta për t'u kuptuar, për aktorët jo-publikë që dëshirojnë të kuptojnë, marrin pjesë dhe influencojnë konsultimet publike në Shqipëri.

2. Kuadri ligjor dhe institucional

Procesi i konsultimit publik në Shqipëri rregullohet kryesisht nga Ligji nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, i cili përbën bazën ligjore për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen qeveritare në nivel qendror. Ky ligj shoqërohet nga akte nënligjore si Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 828/2015 “Për miratimin e rregullave të krijimit dhe administrimit të regjistrit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike” dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 584/2003 “Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave”. Për më tepër, legjislacioni mbi konsultimet publike shoqërohet dhe nga akte nënligjore si Urdhri i Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, nr. 3/2021, ‘Për miratimin e udhëzuesit për procesin e konsultimit publik’ dhe ‘Metodologjia për Vlerësimin e Ndikimit Rregullator (2018)’ e hartuar nga Zyra e Kryeministrit. Këto dokumente synojnë të strukturojnë dhe formalizojnë fazat e konsultimit por megjithatë, një sërë boshllëqesh ligjore dhe institucionale e kanë bërë zbatimin e këtij kuadri të dobët dhe shpesh formal.

Ligji nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” rregullon procesin nëpërmjet të cilit institucionet publike qendrore në Shqipëri përfshijnë qytetarët dhe aktorët e interesuar në hartimin e politikave dhe legjislacionit. Qëllimi kryesor i ligjit është të sigurojë transparencë dhe pjesëmarrje publike në vendimmarrje, duke përcaktuar detyrimin e institucioneve për të njoftuar publikun dhe për të ofruar hapësirë për komente mbi projektligje, strategji kombëtare apo vendore dhe dokumente të tjera me rëndësi të lartë publike.

Ligji parashikon procedura dhe afate të qarta, përfshirë publikimin e projekt-dokumenteve dhe relacionit shpjegues në një regjistër elektronik të dedikuar për konsultime publike. Ligji përkufizon rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve publike në lehtësimin e procesit të konsultimit, përfshirë emërimin e koordinatorëve institucionalë dhe hartimin e raporteve vjetore të transparencës. Ai njuh përdorimin e metodave të ndryshme të konsultimit, si platformat online, takimet publike apo konsultimet me shkrim, dhe mbështetet në parime si aksesueshmëria, gjithëpërfshirja dhe llogaridhënia.


Megjithëse ligji vendos një bazë ligjore për një qeverisje më gjithëpërfshirëse, zbatimi i tij efektiv varet nga angazhimi institucional, kapacitetet administrative dhe ndërgjegjësimi i publikut. Gjatë viteve, përvoja në zbatim ka nxjerrë në pah nevojën për përmirësime të mëtejshme, sidomos në drejtim të monitorimit, zbatueshmërisë dhe harmonizimit të praktikave të konsultimit ndërmjet institucioneve të ndryshme.



2. Kuadri ligjor dhe institucional

Me Urdhrin nr. 3, datë 29.01.2021, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave miratoi udhëzuesin për procesin e konsultimit publik, i cili synon të përmirësojë standardet dhe të unifikojë praktikën e ministrave dhe institucioneve qendrore. Dokumenti përfshin të gjitha fazat e konsultimit, parashikon raportime periodike dhe ngarkon Zyrën e Kryeministrit me monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së procesit. Ky udhëzues mbetet një dokument praktik që udhëzon dhe standardizon proceset e konsultimit publik por zbatimi i të cilit mbetet i kufizuar.

Mbikëqyrja e procesit të konsultimeve publike është aktualisht e përqendruar në Zyrën e Kryeministrit, ndërkohë që KDIMDP ka një mandat të kufizuar sipas të cilit mund të trajtojë ankesat e subjekteve pas miratimit të një akti, por nuk ka kompetenca për të vendosur sanksione apo për të nisur hetime administrative me iniciativë. Ankesa mund të paraqitet pranë KDIMDP pas miratimit të aktit dhe afati për paraqitjen e saj është brenda 30 ditëve nga data e miratimit. Pas paraqitjes, KDIMDP zhvillon një hetim administrativ në respektim të Kodit të Procedurave Administrative dhe i propozon organit publik në fjalë të ndër marrë masa administrative ndaj personit ose personave përgjegjës për parregullsinë, në përputhje me legjislacionin për shërbimin civil në fuqi. Kjo e bën mekanizmin e ankimit joefektiv në shumë raste, duke marrë parasysh edhe faktin që shumë institucione nuk zotërojnë mekanizma të brendshëm për trajtimin e ankesave të qytetarëve në kuadër të proceseve të konsultimeve publike.



3. Llojet e konsultimeve publike

Konsultimet publike në Shqipëri mund të zhvillohen në forma të ndryshme, varësisht nga natyra e dokumentit, faza e procesit vendimmarrës dhe niveli i angazhimit të institucioneve për të përfshirë qytetarët dhe aktorët e interesuar. Këto forma ndahen përgjithësisht në konsultime fizike formale/joformale, konsultime elektronike, dhe mekanizma të tjerë pjesëmarrës që synojnë përfshirjen e komunitetit përmes përdorimit të mjeteve digjitale apo ndërveprimeve të drejtpërdrejta.

Konsultimet formale janë ato konsultime të përcaktuara qartë nga kuadri ligjor, sidomos nga Ligji nr. 146/2014. Ato aplikohen për dokumente me rëndësi të lartë publike, si projektligjet, strategjitë kombëtare apo buxhetet. Në këto raste, institucioni publik është i detyruar të publikojë dokumentet për konsultim në Regjistrin Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, duke ofruar një afat minimal për komente dhe më pas të marrë në shqyrtim mendimet e marra. Këto konsultime zakonisht zhvillohen në fazën përfundimtare të hartimit të një akti, pavarësisht se sugjerohet të mbahen që në fazat e hershme të hartimit.


Përtej këtyre, **konsultimet joformale (konsultimet paraprake)** kanë karakter më fleksibël dhe nuk janë të detyrueshme me ligj. Ato zhvillohen kryesisht në fazat e para të konceptimit të një politike apo ligji dhe ofrojnë një mundësi të rëndësishme për përfshirje më të thellë të publikut. Këto mund të marrin formën e takimeve me grupe interesi, intervistave apo sondazheve të thjeshta.

Shembull: Nisma “Këshillimi Kombëtar” (2022), e ndërmarrë nga Zyra e Kryeministrit, ku qytetarët u ftuan të plotësonin një pyetësor përmes të cilit shprehnin opinionin e tyre mbi drejtimit strategjike të qeverisë në lidhje me çështje të caktuara me interes publik.

Në vitet e fundit, ka pasur rritje të përdorimit të **platformave dhe metodave digjitale për qëllime konsultimi**. Portali kryesor për publikimin e informacionit dhe ndërveprimin e institucioneve me qytetarët është Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (konsultimipublik.gov.al). Megjithatë, përdorimi i mjeteve digjitale mbetet ende i kufizuar në funksionalitet dhe akses, sidomos për grupet më pak të përfaqësuara ose më pak të familjarizuara me teknologjinë.

Së fundmi, ka forma të tjera pjesëmarrjeje të cilat, edhe pse nuk janë gjithmonë të lidhura drejtpërdrejt me ligjin për konsultimet publike, përbëjnë mekanizma të vlefshëm për përfshirjen qytetare. Këtu përfshihen praktika të përdorura kryesisht nga pushteti vendor si **buxhetimi me pjesëmarrje, takimet në komunitet apo forumet e hapura**. Në disa bashki, këto metoda janë përdorur për hartimin e prioritetëve buxhetore apo për identifikimin e nevojave në nivel vendor, duke kontribuar në ndërtimin e një qeverisjeje më të hapur dhe gjithëpërfshirëse në këto lokalitete.

4. Hapat kryesorë institucional në procesin e konsultimit publik^[1]



[1] Urdhër nr.3, datë 29.01.2021 për Miratimin e Udhëzuesit për Procesin e Konsultimit Publik

5. Çfarë aktesh përfshihen në konsultim?

Ligji nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” përcakton qartë fushën e akteve që duhet t’i nënshtrohen konsultimit publik. Në të përcaktohen tre kategori aktesh që duhen përfshirë në proces: projektligjet, përpara se të miratohen nga Kuvendi; projekt-dokumentet strategjike, qofshin ato në nivel kombëtar apo vendor; si dhe politikat që kanë interes të lartë publik. Për sa i përket kësaj të fundit, ekzistojnë kritere të përfshirjes që shërbejnë për të përcaktuar nëse një akt i propozuar ka interes të lartë publik. Konsultimi publik bëhet i detyrueshëm kur politikat e propozuara kanë ndikim të konsiderueshëm mbi grupe sociale ose ekonomike, kur këto politika përfshijnë organizata apo subjekte që do të jenë pjesë e zbatimit, kur konsultimi bëhet i detyrueshëm përmes kërkesave ligjore të fushës së politikave në fjalë, ose kur kanë lidhje të drejtpërdrejtë me interesa e qëllime të caktuara të grupeve shoqërore. Gjithashtu, konsultimi është i domosdoshëm kur politikat e reja që do të prezantohen paraqesin të drejta apo detyrime të reja për qytetarët, ose kur media dhe opinioni publik tregojnë interes të lartë mbi çështjen e propozuar. Këto kritere synojnë të garantojnë që vendimmarrja publike të jetë sa më gjithëpërfshirëse dhe e bazuar në transparencë.

Ligji parashikon gjithashtu një sërë përjashtimesh nga procesi i konsultimit publik, të cilat janë të përcaktuara në nenin 4 dhe lidhen kryesisht me mbrojtjen e interesave thelbësore të shtetit dhe me nevojën për vendimmarrje të shpejtë në rrethana të caktuara. Konkretisht, dispozitat e ligjit nuk zbatohen për çështjet e sigurisë kombëtare që përbëjnë sekret shtetëror, sipas ligjit për informacionin e klasifikuar, pasi publikimi apo diskutimi i tyre do të cenonte sigurinë e vendit dhe mbrojtjen e qytetarëve. Në të njëjtën linjë, të përjashtuara janë edhe marrëdhëniet ndërkombëtare dhe marrëveshjet

dypalëshe ose shumëpalëshe, për shkak se këto procese zakonisht përfshijnë elementë negociatash diplomatike dhe strategjike, të cilat nuk mund të ekspozohen në mënyrë të plotë ndaj publikut pa rrezikuar interesat shtetërore. Përjashtim përbëjnë gjithashtu aktet administrative individuale dhe ato me karakter normativ, pasi natyra e tyre shpesh lidhet me situata të kufizuara apo subjekte të veçanta, të cilat nuk kërkojnë konsultim të gjerë publik, përveç rasteve kur ligje specifike parashikojnë ndryshe.

Përtej këtyre, ligji përcakton si të përjashtuara edhe aktet normative me fuqi ligji të miratuara nga Këshilli i Ministrave, duke marrë parasysh faktin se ato shpesh miratohen në rrethana urgjente që nuk lënë hapësirë për proces konsultimi të gjatë. Po ashtu, çështjet e emergjencës civile përbëjnë një tjetër fushë ku konsultimi publik nuk zbatohet, sepse vendimmarrja e menjëhershme është thelbësore për garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit publik. Së fundmi, ligji parashikon edhe një dispozitë të hapur, sipas së cilës mund të ketë raste të tjera përjashtimore të përcaktuara nga legjislacione të posaçme, duke i lënë kështu hapësirë fleksibilitetit institucional për t’iu përgjigjur situatave të paparashikuara.

Këto përjashtime mund të shfaqen si pengesa për transparencën, por janë faktikisht një mekanizëm për të balancuar nevojën për pjesëmarrje qytetare me domosdoshmërinë e ruajtjes së interesave jetike të shtetit dhe efikasitetit të institucioneve në rrethana të caktuara. Në këtë mënyrë, ligji krijon një mekanizëm të balancuar: nga njëra anë, siguron që aktet me ndikim të gjerë dhe të dukshëm publik të mos kalojnë pa u konsultuar. Nga ana tjetër, shmang konsultimet për akte që përbëjnë përjashtim ligjor, për shkak të natyrës së tyre të ndjeshme ose specifike.

6. Kush mund të marrë pjesë?

Konsultimet publike në Shqipëri janë të hapura për një gamë të gjerë aktorësh, pa vendosur kufizime të posaçme ligjore mbi pjesëmarrjen.

Çdo shtetas shqiptar, pavarësisht statusit apo përkatësisë, ka të drejtë të marrë pjesë në proceset e konsultimit publik, duke shprehur mendimet, shqetësimet apo propozimet e tij mbi politikat dhe aktet që prekin interesin publik. E drejta për të marrë pjesë në vendimmarrje është një nga parimet bazë të qeverisjes demokratike dhe është e garantuar si nga legjislacioni kombëtar ashtu edhe nga angazhimet ndërkombëtare të shtetit shqiptar.

Ligji nr. 146/2014 nuk parashikon një regjistër të pjesëmarrësve apo ndonjë procedurë për të “kualifikuar” kush mund të marrë pjesë. Kjo qasje e hapur synon të inkurajojë një pjesëmarrje sa më të gjerë dhe gjithëpërfshirëse, duke u bazuar në parimin se çdokush ka të drejtë të jetë i dëgjuar kur bëhet fjalë për politika që ndikojnë në jetën e tij apo të komunitetit ku bën pjesë.

Në mënyrë të veçantë, pjesëmarrësit më tipikë në këtë proces janë organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të), të cilat përfaqësojnë zërin e komuniteteve, grupeve të interesit apo kategorive të cënueshme të popullsisë. Po ashtu, palët e interesuara konsistojnë edhe në:

- **Shoqata profesionale dhe sindikata** (p.sh. Dhoma Kombëtare e Avokatëve, Urdhri i Psikologut, Sindikata e Pavarur e Arsimit të Shqipërisë, etj.);
- **Komuniteti i biznesit dhe dhomat e tregtisë** për vendimmarrje me ndikim të fortë ekonomik;
- **Institucione akademike dhe studiues** që kanë ekspertizë në fushën që po konsultohet;
- **Komunitete vendore dhe përfaqësues të tyre**, veçanërisht kur bëhet fjalë për strategji apo vendime që prekin territorin ose shërbimet vendore;
- **Grupe të rinjve, të moshuarve, personave me aftësi të kufizuara, komuniteteve etnike ose fetare, etj.**



7. Ndjekja dhe monitorimi i konsultimeve publike

Monitorimi i proceseve të konsultimit publik është thelbësor për të siguruar transparencën dhe llogaridhënien në vendimmarrje. Qytetarët, organizatat e shoqërisë civile dhe aktorë të tjerë mund të ndjekin zhvillimin e konsultimeve publike duke identifikuar në kohë nismat legjislative ose politike që janë në fazë hartimi apo shqyrtimi. Kjo përfshin njohjen me kalendarët e konsultimeve të institucioneve, dokumentet që hidhen për konsultim dhe përdorimin e mjeteve digjitale që ofrohen nga institucionet për ndërveprimin me to.

Një nga mjetet kryesore është Regjistri Elektronik i Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike (www.konsultimipublik.gov.al), i cili përbën portën zyrtare për publikimin e projektligjeve, strategjive apo dokumenteve të tjera të rëndësishme për konsultim. Përdorimi i këtij regjistri është i detyrueshëm për institucionet publike dhe u mundëson qytetarëve të identifikojnë projektaktet që ndodhen në proces konsultimi, afatet për komente dhe të shohin historikun e dokumenteve të publikuara. Regjistrimi në portal, mund të bëhet duke përdorur kredencialet ekzistuese që përdoruesi zotëron në e-Albania. Përdoruesit e portalit kanë gjithashtu mundësinë të regjistrohen për marrjen e njoftimeve automatike, duke klikuar në komandën “Merr Njoftim” në fund të faqes, dhe duke përcaktuar institucionet prej së cilëve janë të interesuar që të marrin njoftime automatike.

Përtej platformave zyrtare, është e rëndësishme që aktorët e interesuar të ndjekin kalendarët vjetorë të konsultimeve të institucioneve publike ku shpesh bëhen publike prioritetet ligjvënëse dhe projektaktet që do të konsultohen përgjatë vitit të ardhshëm. Kjo praktikë mundëson përgatitje paraprake dhe përfshirje më të mirë të grupeve të interesit në kohën e duhur. Planet Vjetore të Konsultimit Publik mund të aksesohen në RENJKP, dhe me raste edhe në faqet respektive të institucioneve. Gjithashtu, për të kuptuar më tepër mbi prioritetet ligjvënëse të institucioneve mund të konsultohen edhe Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve (PPAP) dhe Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE).

Kur informacioni nuk është i publikuar apo nuk gjendet në mënyrë të aksesueshme, mund të përdoret instrumenti i kërkesës për informacion mbi bazën e Ligjit për të Drejtën e Informimit (ligji nr. 119/2014). Çdo individ apo organizatë ka të drejtë të kërkojë informacion nga një institucion publik lidhur me dokumentet që janë në fazë hartimi, planifikimin e konsultimeve, afatet apo format e parashikuara të pjesëmarrjes. Kjo është një mënyrë efektive për të kërkuar transparencë dhe për të siguruar që proceset e konsultimit nuk do të zhvillohen në mënyrë të mbyllur apo përjashtuese.

8. Si të angazhohesh në mënyrë efektive?

Pjesëmarrja në konsultimet publike është më e dobishme kur bëhet në mënyrë të strukturuar dhe me argumente të forta. Një angazhim efektiv kërkon përgatitje, bashkëpunim dhe përdorim të kanaleve të duhura për të ndikuar realisht në procesin e vendimmarrjes.

Përgatitja e kontributeve të qarta dhe të bazuara në fakte

Çdo koment, propozim apo kundërshtim i prezantuar në konsultimet publike duhet të mbështetet mbi të dhëna konkrete, analiza dhe prova të qarta. Kjo mund të përfshijë statistika, praktika të mira nga vende të tjera, raporte kërkimore apo përvojë nga terreni. Argumentet e bazuara në evidencë kanë më shumë gjasa të merren seriozisht nga institucionet. Gjithashtu, sugjerohet që komentet të jenë specifike, duke identifikuar nenin/pjesën përkatëse që duhet ndryshuar/rishikuar, si dhe duke ofruar sugjerime për riformulime. Sugjerimet parimore dhe të përgjithshme, kanë më pak gjasa të pranohen dhe janë më të vështira për t'u identifikuar në tekst.

Organizimi i qëndrimeve kolektive

Kur disa aktorë të shoqërisë civile ndajnë të njëjtat shqetësime apo propozime, është e dobishme të bashkohen në koalicione, rrjete apo iniciativa të përbashkëta. Qëndrimet e paraqitura nga një grup i gjerë organizatash ose qytetarësh, përmes peticioneve, deklaratave të përbashkëta ose raporteve të përbashkëta, kanë tendencën të kenë peshë më të madhe dhe ndikim më të gjerë. Kjo formë bashkëpunimi jo vetëm rrit fuqinë advokuese dhe besueshmërinë e propozimeve, por gjithashtu ndihmon në përdorimin më efikas të resurseve dhe ndarjen e ekspertizës mes aktorëve të ndryshëm.

Përdorimi i deklaratave publike dhe mediave

Media tradicionale dhe platformat online janë mjete të rëndësishme për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të ushtruar presion pozitiv mbi institucionet. Artikujt, intervistat, postimet në rrjete sociale dhe fushatat mediatike mund të bëjnë që çështje të caktuara të marrin më shumë vëmendje publike dhe institucionale. Përveç vëmendjes institucionale, kjo taktikë mund të afrojë persona apo grupe me qëllime të njëjta por perspektiva të reja, duke rritur kështu numrat dhe forcën e komunitetit advokues. Gjithashtu, përmes përdorimit strategjik të medias, aktorët e shoqërisë civile mund të formësojnë narrativën publike rreth një teme dhe të nxisin një debat më gjithëpërfshirës, duke e bërë më të vështirë për institucionet të anashkalojnë shqetësimet e ngritura. Megjithatë, përdorimi i pakujdesshëm ose i tepërt i medias mund të sjellë rreziqe, si keqinterpretimi i mesazhit apo ulja e interesit publik për shkak të ekspozimit të vazhdueshëm.

Pjesëmarrja aktive në dëgjesa dhe konsultime publike

Prania fizike ose online në takimet konsultuese dhe dëgjesat publike u jep mundësi pjesëmarrësve të shprehin mendimet e tyre drejtpërdrejt, të bëjnë pyetje dhe të ndjekin nga afër reagimet e institucioneve. Kjo gjithashtu shërben për të ndërtuar besueshmëri si aktorë të angazhuar dhe të informuar. Megjithëse çdo formë pjesëmarrjeje qoftë me shkrim apo fizike ka ndikim pozitiv në proces, prania fizike me zë dhe figurë është e pazëvendësueshme për sa i përket shanseve që mesazhi të përçohet në mënyrën e duhur. Përveç kësaj, pjesëmarrja e drejtpërdrejtë krijon hapësira për ndërveprim informal me vendimmarrësit dhe aktorë të tjerë të pranishëm, duke forcuar lidhjet dhe rritur mundësinë që sugjerimet të merren parasysh në mënyrë më serioze.

8. Si të angazhohesh në mënyrë efektive?



Ndërtimi i marrëdhënieve me zyrtarët publikë

Bashkëpunimi i vazhdueshëm dhe komunikimi korrekt me punonjësit dhe drejtuesit e institucioneve publike krijon ura besimi. Marrëdhëniet profesionale të ndërtuara përgjatë eksperiencave të mëparshme profesionale, mund të lehtësojnë qasjen e aktorëve jo-publikë në informacion, konsultim dhe përfshirje në procese vendimmarrëse. Krijimi i kontakteve të besueshme shpesh ndihmon që shqetësimet e shoqërisë civile të merren parasysh më herët në proces, duke ulur mundësinë që ato të anashkalohen. Në këtë mënyrë, ndërtimi i marrëdhënieve të qëndrueshme me zyrtarët publikë nuk është thjesht një taktikë për të pasur qasje më të lehtë, por një strategji afatgjatë për të rritur ndikimin dhe efektivitetin e pjesëmarrjes qytetare.

Ndjekja e akteve deri në miratim

Pjesëmarrja e efektshme nuk përfundon me dorëzimin e komenteve gjatë fazës së konsultimit, por kërkon një angazhim të vazhdueshëm për të ndjekur ecurinë e aktit deri në miratimin përfundimtar. Shpesh, miratimi i akteve ndodh me vonesa të mëdha kohore, siç dëshmohet edhe nga fakti që më pak se gjysma e akteve të konsultuara miratohen brenda të njëjtit vit që ato konsultohen.[2] Kjo ngre hipoteza për mungesë efektiviteti në planifikim nga institucionet, apo dhe ndikimin e faktorëve të ndryshëm burokratikë apo politikë. Gjatë kësaj periudhe, dokumentet mund të pësojnë ndryshime të rëndësishme, të cilat rrezikojnë të zbehin ose të fshijnë plotësisht kontributin e dhënë nga publiku gjatë konsultimit.

Për këtë arsye, është thelbësore që qytetarët, shoqëria civile dhe aktorët e interesuar të vazhdojnë të monitorojnë procesin, të kërkojnë transparencë mbi amendimet e reja dhe të sigurohen që mendimet e tyre të mbeten pjesë e diskutimit edhe në fazat pasuese. Vetëm kështu garantohet që pjesëmarrja të ketë ndikim real dhe të mos reduktohet në një formalitet procedural.

Angazhimi në fazën e hartimit të akteve

Një nga sfidat kryesore të konsultimeve publike në Shqipëri lidhet me faktin se llogaridhënia dhe pjesëmarrja në fazën fillestare të hartimit të akteve mbetet e ulët. Kjo fazë përbën një periudhë kritike, pasi konsultimet ofrojnë më shumë mundësi për të ndikuar realisht mbi përmbajtjen e një akti apo për të sugjeruar alternativa që mund të mos merren parasysh më vonë. Megjithatë, praktika tregon se për rreth dy nga pesë projektakte mungon informacioni mbi fazën e hartimit[3], duke e bërë të vështirë për aktorët e interesuar të kuptojnë kur dhe si të përfshihen. Për këtë arsye, pjesëmarrja efektive kërkon një qasje proaktive: qytetarët, organizatat dhe grupet e interesit duhet të kërkojnë me këmbëngulje informacion, të zhvillojnë kontakte me institucionet dhe të ofrojnë kontributin e tyre që në hapat e parë të procesit.

[2] Reçi, M., & Angjeli, D. (2025). Konsultimi Publik në Shqipëri: Iluzioni i Përfshirjes. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. (pp. 41-42)

[3] Reçi, M., & Angjeli, D. (2025). Konsultimi Publik në Shqipëri: Iluzioni i Përfshirjes. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. (pp. 48-50)

9. Pengesat e zakonshme dhe si mund t'i kapërceni ato

Proceset e konsultimit publik shpesh përballen me pengesa që e bëjnë më të vështirë pjesëmarrjen kuptimplotë. Njohja e këtyre sfidave dhe përdorimi i strategjive për t'i kapërcyer është thelbësore për të rritur efektin e angazhimit.

Mungesa e transparencës ose njoftimit

Në disa raste, informacioni për konsultimet nuk publikohet në kohë ose është i pjesshëm. Për ta kapërcyer këtë duhen ndjekur rregullisht faqet zyrtare dhe portalet e konsultimeve, si dhe të kërkohet informacion përmes kërkesave zyrtare për të drejtën e informimit. Gjithashtu, këshillohet të mbahen kontakte të vazhdueshme me zyrtarët përgjegjës dhe rrjetet e organizatave, në mënyrë që të jeni gjithmonë të përditësuar me njoftimet dhe afatet.

Afatet e kufizuara kohore

Institucionet shpesh ofrojnë periudha shumë të shkurtra për komente, tipikisht afatin minimal prej 20 ditësh, pavarësisht nivelit të rëndësisë, kompleksitetit apo volumit të projektaktit në fjalë.[4] Për të përballuar këto sfida, është e domosdoshme përgatitja dhe trajnimi i stafit në fushën e konsultimit dhe advokimit, në mënyrë që reagimet të jenë sa më të mirë-argumentuara dhe efektshme pavarësisht kufizimeve kohore. Për më tepër, duhet konsideruar bashkëpunimi me aktorë të tjerë në mënyrë që të ndahet barra e përgatitjes së komenteve.

Mosmarrja parasysh e komenteve

Shpeshherë sugjerimet e dërguara tek institucionet përgjatë konsultimeve publike nuk reflektohen në aktet përfundimtare.[5] Për të adresuar këtë, është e rëndësishme që subjektet të kontrollojnë nëse komentet janë publikuar pas konsultimeve dhe nëse ato janë të shoqëruara me arsyetimet përkatëse. Kontrolli përfshin verifikimin e përdorimit të emrave specifikë të kontribuesve në vend të termave përgjithësues si “shoqëria civile”, “sindikatat” ose “grupet e interesit”, si dhe evidentimin e rasteve ku tabelat janë të paplotësuara ose bosh, pa analizë për mungesën e komenteve, ose kur komentet nuk janë publikuar pavarësisht mbajtjes së tryezave të konsultimit.

Rezistenca institucionale

Ndryshimet domethënëse dhe rrënjësore legislative shpesh hasin kundërshtim nga brenda administratës. Përballë këtij fakti, argumentet e prezantuara në konsultime duhet të jenë të bazuara në ligj, të ofrojnë përfitime konkrete dhe të mbështeten mbi praktika të mira ndërkombëtare. Kjo rezistencë mund të trajtohet gjithashtu përmes kërkesës së aktorëve jo-publikë për t'u bërë pjesë që në fazat e hershme të konsultimit, me synimin që përfshirja e hershme të shmangë konfliktet dhe kursejë kohë në procesin e vendimmarrjes. Për më tepër, angazhimi i medias dhe opinionit publik mund të ndihmojë gjithashtu në thyerjen e kësaj rezistence.

[4] Reçi, M., & Angjeli, D. (2025). Konsultimi Publik në Shqipëri: Iluzioni i Përfshirjes. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. (pp. 37-39)

[5] Reçi, M., & Angjeli, D. (2025). Konsultimi Publik në Shqipëri: Iluzioni i Përfshirjes. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. (pp. 25-27)

10. Matja dhe treguesit e suksesit

Matja e suksesit të konsultimeve publike është thelbësore për të kuptuar nëse procesi ka qenë i hapur, gjithëpërfshirës dhe ka sjellë ndryshime të prekshme. Përdorimi i treguesve lejon që institucionet dhe aktorët jo-publikë të analizojnë pikat e forta dhe mangësitë e procesit, si dhe të ndërmarrin hapa për përmirësimin e tij në të ardhmen. Këta indikatorë mund të grupohen përgjithësisht në katër fusha kryesore: transparencja, pjesëmarrja, cilësia e përgjigjeve dhe rezultatet konkrete.

Transparencja vlerëson mënyrën se si institucionet publikojnë dhe shpërndajnë informacionin mbi konsultimet publike dhe ecurinë e proceseve vendimmarrëse. Ajo nënkupton jo vetëm njoftimin në kohë të konsultimeve dhe qasjen e lehtë në dokumentet përkatëse, por edhe publikimin e komenteve të marra nga aktorët e interesuar dhe statusin e aprovimit apo refuzimit të tyre. Një transparencë e plotë përfshin gjithashtu raportimin e ecurisë së fazës së hartimit të projektaktit, duke përfshirë afatet, versionet e ndryshuara të teksteve dhe çdo konsultim me palë të dyta dhe të treta (p.sh., ekspertë, grupe interesi, institucione të tjera).

Pjesëmarrja mat shkallën dhe cilësinë e përfshirjes së aktorëve jo-publikë në procesin e konsultimit publik. Kjo përfshin jo vetëm pjesëmarrjen numerike, por edhe përfaqësimin e sektorëve të ndryshëm, si shoqëria civile, biznesi, academia dhe qytetarët individualë. Një pjesëmarrje efektive nuk varet vetëm nga gatishmëria e aktorëve për të dhënë komente, por edhe nga zgjedhja e kujdesshme e metodave të konsultimit nga ana e institucioneve. Këto metoda duhet të jenë gjithëpërfshirëse, të aksesueshme dhe të përshtatura me natyrën e aktit dhe grupin e synuar – duke kombinuar njoftimet elektronike, dëgjесat publike, konsultimet me ekspertë dhe format e tjera interaktive që lehtësojnë dialogun dhe shkëmbimin e mendimeve.

Kur institucionet ofrojnë mundësi të balancuara dhe të përshtatshme për pjesëmarrje, rritet probabiliteti që rezultatet e konsultimeve të reflektojnë më mirë nevojat dhe prioritetet e publikut.

Cilësia e përgjigjeve lidhet me mënyrën se si institucionet i kanë trajtuar dhe reflektuar komentet e marra gjatë konsultimit. Treguesi pozitiv në këtë rast është kur përgjigjet janë të argumentuara, të dokumentuara dhe shpjegojnë qartë arsyet e pranimi ose refuzimit të propozimeve. Aplikimi i duhur i kësaj faze krijon besim mes publikut dhe institucioneve, si dhe nxit pjesëmarrjen e ardhshme.

Rezultatet konkrete fokusohen te ndikimi konkret i konsultimeve publike në përmbajtjen përfundimtare të aktit ose politikës. Ky indikator vlerëson nëse propozimet dhe komentet kanë sjellë ndryshime të dukshme në projektaktin final dhe nëse vendimmarrja ka fituar në cilësi. Vlerësimi i rezultateve lejon të kuptohet nëse procesi ka qenë thjesht formal apo ka pasur një efekt transformues.



11. Praktika të mira

PROJEKTLIGJI “PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE” (2024)

Më 20 gusht 2024 Ministria e Turizmit dhe Mjedisit hodhi për konsultim Projektligjin “Për Menaxhimin e IntegrUAR të Mbetjeve” (me afat datën 17 shtator). Seksioni respektiv në RENJKP u paraqiste qytetarëve projektligjin, relacionin shpjegues, dhe Vlerësimin e Ndikimit Rregullator (VNR).

Pika kyçe në këtë projektligj që do të sillte debatin e madh që do të vijonte më tej qëndronte te Neni 73 i projektligjit: megjithëse Shqipëria kishte të vendosur ndalimin e plotë të importit të mbetjeve, drafti hapte një derë duke thënë se importi i mbetjeve jo-të-rrezikshme mund të lejohej më vonë me vendim të Këshillit të Ministrave. Kjo ndezi një reagim të shpejtë dhe të bazuar në rregulla nga ana e aktorëve jo-publikë. Grupet mjedisore (Aleanca Kundër Importit të Plehrave dhe të tjerë), inxhinierë dhe juristë dorëzuan komentet e tyre përmes portalit të konsultimeve publike dhe e-maileve. Ata u shprehën se dispozita binte ndesh me rregullat e BE-së, me strategjitë kombëtare dhe me kapacitetin e kufizuar të autoriteteve përkatëse për të kontrolluar portet e pikat kufitare.

Deri në afatin përfundimtar, në portal u grumbulluan rreth 21 komente. Më pas, në fillim të nëntorit, Ministria mbajti një takim publik ku të njëjtat pika u ripërsëritën qartë: mbajtja në fuqi e ndalimit të plotë të importit të mbetjeve, eliminimi i dispozitave përjashtuese që mund të lenë vend për tërheqjen e këtij ndalimi më pas, si dhe vlerësimi i drejtë i burimeve dhe kapaciteteve mbikëqyrëse që kanë autoritetet përkatëse. Versioni i ri i projektligjit dhe Raporti Individual i Ministrisë i pasqyroi këto tema, gjë që solli kthesën e dëshiruar. Teksti i ndryshuar fshihi mundësinë e importit dhe riktheu rregullin e qarte të moslejimit të importit të mbetjeve të rrezikshme dhe jo-të-rrezikshme.

Vëzhgues dhe gazetarë ndoqën me kujdes përgatitjen e versionit të rishikuar, duke shpërndarë pamje “para-pas” të ndryshimit të nenit. Në këtë rast, qasja e aktorëve jo-publikë funksionoi pasi këta të fundit përdorën ligjin e konsultimit siç duhet duke dhënë përgjigje në kohë, cituar bazën ligjore, shtyrë Vlerësimin e Ndikimit Rregullator (VNR) të llogariste koston reale të zbatimit, kërkuar takime vijuese dhe duke i lënë gjurmët zyrtare. Rezultati verifikohet muaj më vonë: klauzola e rrezikshme u hoq, ndalimi i importit qëndron dhe çdo hap është i mirë-dokumentuar.



Foto: LSA/BIRN

11. Praktika të mira

PROJEKTLIGJI PËR AMNISTINË FISKALE DHE PENALE PËR SUBJEKTET QË BËJNË DEKLARIM VULLNETAR TË PASURIVE (2020–2023)

Projektakti i amnistisë fiskale/penale u publikua dy herë në portalin e konsultimeve: njëherë përgjatë 6 korrik–6 gusht 2020 dhe së dyti përgjatë 23 qershor–23 korrik 2022. Sipas këtij projektligji, individëve do t'u ofrohej amnisti fiskale për pasuri të padeklaruara, kundrejt një takse fikse.

Në letër dukej sikur kjo iniciativë do integronte të ardhura të shpejta në sistemin ekonomik shqiptar por në praktikë ngriti katër sinjale të qarta që u përsëritën shpesh nga aktorë jo-publikë. Së pari, kjo nismë mund të dobësonte kontrollet kundër pastrimit të parave në një kohë kur vendi kërkonte të dilte nga lista gri e Task Forcës për Veprim Financiar (FAFT). Së dyti, ky veprim do të ishte i padrejtë ndaj tatimpaguesve korrektë shqiptarë. Së treti, ky proces do të ishte i vështirë për t'u kontrolluar, sepse verifikimi i origjinës së fondeve do të kërkonte njerëz dhe sisteme që Shqipëria ende nuk i kishte. Së fundmi, implementimi i këtij ligji do të dëmtonte imazhin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE, duke marrë parasysh edhe rezervat e aktorëve ndërkombëtarë ndaj kësaj iniciative.

Mes të tjerash, aktorët jo-publikë i kërkuan Ministrisë të tregonte brenda VNR-së se si do të financoheshin dhe plotësoheshin me staf auditimi, monitorimi i transaksioneve dhe verifikimet përkatëse.

Gjatë dritareve të konsultimit, grupe biznesi, OJF dhe ekspertë dorëzuan shënime formale dhe mbajtën deklarata publike. Edhe pse në portal u regjistruan pak komente, u përdorën mënyra alternative të cilat siguruan që procesi të ruante vlerën e tij. Kjo pasi letrat e aktorëve jo-publikë drejtuar institucioneve u regjistruan, takimet u pasuan nga procesverbale dhe afatet institucionale detyruan kthimin e përgjigjeve. Qëndrimet e BE-së dhe FMN-së u hodhën gjithashtu në letër, me institucionet ndërkombëtare që paralajmëruan se një amnisti do të minonte reforma ekzistuese të rëndësishme.

Përgjatë periudhës 2022–2023 projektligji mbeti i hapur dhe zhvillohej vazhdimisht përmes integritit të varianteve, pragjeve, përjashtimeve dhe listave të filtrimit. Gjithsesi rreziku bazë nuk ndryshoi, ndaj nga fundi i vitit 2023 qeveria e pezulloi qetësisht projektligjin dhe ky i fundit nuk shkoi në Parlament. Përgjatë gjithë procesit, aktorët jo-publike përdorën kanale formale për të prezantuar me shkrim shifra, kundër-argumente dhe citime. Përmes qëndrueshmërisë dhe forcës së argumenteve të tyre, drafti u la mënjanë dhe e shndërroi projektligjin në një kauzë të pambrojtshme.




Foto: ATSH

12. Listë kontrolli për pjesëmarrje efektive

1. Kuptimi i kuadrit ligjor dhe afateve

- ☐ Kam verifikuar nëse projektakti për të cilin jam i interesuar hyn në kategoritë që sipas ligjit duhet t'i nënshtrohen konsultimit publik (projektligje, strategji, politika me interes të lartë publik).
- ☐ Kam kontrolluar nëse afati i konsultimit është respektuar (minimumi 20 ditë kalendarike).
- ☐ Kam parashikuar kohë për të analizuar materialet (volumi, kompleksiteti, nevoja për ekspertizë).
- ☐ Nëse është e nevojshme, kam dërguar kërkesë për zgjatje afati me arsyetim të qartë.

2. Përgatitja për përmbajtjen

- ☐ Kam lexuar projektaktin dhe relacionin shpjegues përkatës.
- ☐ Kam identifikuar nenet/pikat më të rëndësishme për komunitetin apo grupin që përfaqësoj.
- ☐ Kam mbledhur të dhëna, statistika, praktika krahasuese ose evidenca që mbështesin komentet e mia.
- ☐ Kam konsultuar komunitetin/grupin që përfaqësoj për të marrë qëndrime dhe shqetësime.
- ☐ Kam vendosur qartë formatin e komenteve: (Problemi → Propozimi → Arsyeja).

3. Strategjia e angazhimit

- ☐ Kam vendosur nëse do të paraqitem fizikisht në dëgjese apo do të dorëzoj komente me shkrim.
- ☐ Jam koordinuar me aktorë të tjerë që ndajnë shqetësime të ngjashme (deklaratë e përbashkët, peticion, raport i përbashkët).
- ☐ Kam përgatitur mesazhe për media apo rrjete sociale për të rritur ndërgjegjësimin (nëse është e përshtatshme).
- ☐ Kam identifikuar zyrtarët kyç dhe koordinatorin e konsultimit me të cilët mund të ndërveproj.
- ☐ Kam përgatitur pyetje konkrete për t'i adresuar gjatë takimit/dëgjesës publike.

4. Etika dhe transparenca

- ☐ Kam qartësuar se kë përfaqësoj dhe bazën e mandatit tim për të dhënë komente.
- ☐ Kam verifikuar që kontributi im është pa konflikt interesi.
- ☐ Jam i gatshëm të ndaj publikisht qëndrimin tim dhe mënyrën si janë mbledhur komentet.

5. Pas konsultimit

- ☐ Kam planifikuar të ndjek ecurinë e projektaktit deri në miratimin përfundimtar.
- ☐ Kam përgatitur një përmbledhje për komunitetin/grupin që përfaqësoj mbi pjesëmarrjen dhe kontributin e dhënë.
- ☐ Kam ruajtur komunikimin me institucionin për të ndjekur ndryshimet dhe për të ushtruar presion pozitiv kur është e nevojshme.

13. Rrugëtimi i pjesëmarrjes efektive në konsultime

- 1 Identifikimi i nismës**
ku do të përfshihen dhe njohja me planet aktuale të institucioneve për konsultimin e projektaktit në fjalë 
- 2 Ngritja e një grupi advokimi**
me qëllim qëndrueshmëri dhe konsolidimin e perspektivave, dhe hartimi i një pozicioni të përgjithshëm mbi çështjen në fjalë 
- 3 Interesim për pjesëmarrje në fazat e hershme të konsultimit**
dhe ndërtimi i marrëdhënieve institucionale me grupin e punës për të siguruar këtë bashkëpunim paraprak 
- 4 Përgatitja e resurseve kohore dhe njerëzore**
që do të përdoren në kuadër të shqyrtimit të draft-aktit, përpara nxjerrjes për konsultim të dokumentit në fjalë 
- 5 Përpilimi i komenteve**
në mënyrë koncize dhe të qartë dhe transmetimi i tyre tek institucionet mundësisht përmes metodave direkte të komunikimit 
- 6 Monitorimi i statusit të komenteve**
dhe referimi i procedurave potencialisht problematike të konsultimit të titullari i institucionit ose KDIMDP 
- 7 Njohja me legjislacionin e ri**
e komunitetit dhe aktorëve kryesorë, në vazhdim të miratimit të dokumentit final 



Prani mediatike dhe komunitare

ku të prezantohen qëndrimi dhe objektivat e përgjithshme të grupit të advokimit. Ky është një proces që duhet të vazhdojë deri në fund të konsultimit.